

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT
DREJTORIA E PROKURIMIT PUBLIK

Data 14.10.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje vazo me përmasa të ndryshme”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

(FPP):

39298300-0_Vazo Lulesh

VLERA E FONDIT LIMIT:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës / Marrëveshjes Kuadër

Fondi limit i procedurës është: 2,500,000 (dy milion e pesëqind mijë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **“Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit”** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: *“...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të*

vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4; perkatesisht në vleren 50,000(pesedhjetë mijë) lekë të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse.

Argumentimi:Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të LPP, nenit 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”

“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit. 3. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1Operatori Ekonomik duhet të disponojë certifikaten ISO 9001:2015 (e vlefshme) mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” e cila të përfshijë objektin e prokurimit. (Ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.).

Të gjitha certifikatat e mësipërme, duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilët janë të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues.

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”,si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,ku përcaktohet se:“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të

jetë **jo më e vogël se 40% vlerës e fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa 40 % vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në nenin 43, pika 2, germa (c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, germa (b) të nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kërkohe vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024),, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së përllogaritur të kontratës, referuar nenin 43 pika 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, pasi kjo është një procedurë e **Hapur e Thjeshtuar**, dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare dhe kapaciteteve ekonomike të operatorëve ofertues, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023, 2024), të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, gjithashtu është kërkuar auditimi ligjor i pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese në rastet e parashikuara në nenin 41, pika ”c” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 . Dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme, me objektin e prokurimit të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës me vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate dhe konkretisht: 500,000 (peseqind mijë) lekë pa TVSH.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Kur furnizimi i se njëjtës natyre është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrateku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimi i së njëjtës natyrë është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë duke paraqitur faturat përkatëse tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori për mallrat e paraqitura. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për vazot plastike të ofertuara.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe në nenin 40, pika 8 të VKM–së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar . Duke qenë se materialet e kerkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm.

Njësia e Prokurimit gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose Distributorit të Autorizuar nga Prodhuesi është nëpërpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitatligjore të sipërcituara.Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Pra nëpërmjet vendosjes së kriterit të sipërpërmendur AK garantohet dhe fiton siguri se operatori ekonomik kontraktues do të furnizojë dhe do të përmbushë kontratën me sukses.

2.3.3 Per mallin e kerkuar te paraqitet katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike.*Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu,si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.*

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar

ku specifikisht parashikohet Autoriteti kontraktor mund t' u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

b) fotografitë apo katalogjet teknike

Paraqitja e katalogëve të prodhuesve është e nevojshme në funksion të verifikimit të përpjethshmërisë së produkteve me specifikimet teknike të AK me qëllim realizimin e kontratës me sukses.

2.3.4 Dëshmi për mjete e paisje teknike, që ka në dispozicion apo që mund ti vihen në dispozicion Operatorit Ekonomik për të përmbushur kontratën. Kërkohen si më poshtë

Të ketë në pronësi ose me qira 1 (një) mjet për transportin e mallit objekt prokurimi. Mjeti të ketë dokumentet si më poshtë:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamionçinë me kapacitet mbajtës 1-1.5 ton	1 copë	Pronësi ose me qira

a) Për mjetet në pronësi, ose mjetet e deklaruara me qira të lidhura me kontratë tek noteri duhet të paraqitet:

- * Certifikatë pronësie.
- * Leje qarkullimi.
- * Certifikatën e kontrollit teknik.
- * Siguracionin e mjetit.

b) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe paisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundim të kontratës.

c) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe paisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedura të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor.

ç) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qira me qëllim verifikimin nga Autoriteti Kontraktor.

d) Për mjetet dhe paisjet teknike që ka deklaruar Operatori Ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe paisje. Në rastin e mjeteve të targura duhet të duken qartë mjeti dhe targa e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të

përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit ”Procedure e Hapure Thjeshtuar–Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 5/ç ”Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

“5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”.

Meqënëse parashikimet e nenit 40 pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcakton se operatorët ekonomikë ofertues në rastin e kontratave të prokurimit të llojit ”mallra” duhet të kenë në dispozicion apo vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e furnizimit të mallrave objekt prokurimi dhe në rastin konkret të automjetetit për transportin e mallit objekt prokurimi, por pa përcaktuar se si disponohen këto automjete dhe meqënëse këto mjete qarkullojnë në territorin shqiptar, ju referuam nenit 81, 83 e 178 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 ”Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Për këtë qëllim është kërkuar që të paraqitet një deklaratë e Operatorëve Ekonomikë ofertues, të cilët duhet të ofrojnë furnizimin me karburant për mjetet e transportit nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar, gjë e cila garanton Autoritetin Kontraktor për realizimin me sukses të kontratës, sipas kuadrit rregullator të përcaktuar në VKM nr.561, datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Nëpërmjet këtij kriteri synohet gjithashtu, edhe evitimi i kostove të shtuara për Autoritetin Kontraktor, sa i përket kostos së prodhimit dhe pajisjes me karta elektronike të personalizuar, në funksion të zbatimit të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke u bazuar në parametrat e lejuara dhe sipas standardeve në fuqi, të cilat përmbushin kërkesat dhe nevojat e AK. Specifikimet teknike për artikullin e kërkuar vazo lulesh, përshkruajnë tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërës, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (neni 36), dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (neni 40 pika 2).

Specifikimi I Materialeve:

1. Vazo me diametër 12 cm, materiali polipropilen, lartësia 12 cm.
2. Vazo me diametër 20 cm, materiali polipropilen, lartësia 20 cm.
3. Vazo me diametër 25 cm, materiali polipropilen, lartësia 25 cm.
4. Vazo me diametër 30 cm, materiali polipropilen, lartësia 30 cm.

5. Vazo me diametër 40 cm, materiali polipropilen, lartësia 40 cm.
6. Vazo me diametër 60 cm, materiali polipropilen, lartësia 60 cm.
7. Vazo me diametër 80 cm, materiali polipropilen, lartësia 80 cm.
8. Vazo me diametër 15 cm (qese), materiali plastmas, lartësia 30 cm.

Përshkrimi i kërkesa vetë zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: Operatori ekonomik duhet të realizojë transportin e mallit me mjetet e tij deri në ambientet e autoritetit kontraktor.

Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.